



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:093947
Datë: 11.05.2023
Numri i dokumentit: 04268180

SCC-10-0320

Paditësi:

G N Gjakovë,
përfaqësuar nga Av T B, Gjakovë

Kundër

E Paditura:

N.SH “Ereniuku”-Prodhimtarija Primare- rr. Skënderbeut”, pn, Gjakovë,
përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP),
Rr. “Dritan Hoxha”, nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Shkelzen Sylaj, Gjyqtar kryesues, Sylejman Shumolli dhe Manushe Karaqi, Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 11 maj 2023, lëshon këtë:

AKTVENDIM

- 1. Ndërpritet procedura gjyqësore në këtë çështje juridike.**
- 2. Procedura e ndërprerë do të vazhdoje atëherë kur trashëgimtarët e paditësit marrin përsipër çështjen juridike.**
- 3. Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 25 tetor 2010, paditësi përmes postës parashtrij padi kundër të paditurës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (tutje DHPGJS) e cila ka të bëjë me vërtetimin drejtës së pronësisë në sipërfaqe prej 2.40.00 ha, në vendin e quajtur “ N L”. Paditësi ka pohuar se ishte trashëgimtar i të ndjerës Xh N, ish nga Gjakova, e cila ishte pronare e ngastrës nr.4973, në sipërfaqe prej 2.40.00 ha, ngastrës nr.4488, në sipërfaqe prej 1.00.00 ha , KK Gjakovë. Ka shtuar se me dt. 08 mars 1982, paraardhësja e tij me të paditurën kishte bërë ndërrimin e paluajtshmëris së lartcekur dhe për ndërrim kishte marr nga e paditura ngastrën nr.4987, pjese ideale në sipërfaqe prej 2.40.00 ha dhe një pjesë të sipërfaqe prej 1.00.00 ha (ngastra e pa specifikuar nga paditësi) , në vendin e quajtur Poligoni Ushtarak të cilat nuk ju kanë dhënë në pronësi.

Me 16 dhjetor 2010, Gjykata me Aktvendim kishte pezulluar lëndën në këtë çështje juridike, për shkak të statusit të paditurës N.SH “Ereniku” që ishte në zhvillim e sipër sipas lëndës SCC-08-0124.

Me 08 janar 2015, Gjykata kishte hequr pezullimin e procedurës në çështjen juridike të paditësit.

Me 25 gusht 2017, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), ka ushtruar mbrojtjen në padi, me të cilën e kundërshton padinë e paditësit si të pabazuar në ligj, me arsyetimin se padia e paditësve nuk e përmban bazën ligjore me të cilën do të mbështetet padia. E paditura e kishte kontestuar edhe legjitimitetin aktiv të palës paditëse dhe për fund i ka kërkuara gjykatës që padinë e paditësit hedh si të papranueshme apo ta refuzoj si të pabazuar.

Me 31 tetor 2022, gjykata kërkoj nga paditësi që të sjellin Aktvendimin e trashëgimisë.

Me 06 dhjetor 2022, djali i paditësit ka dorëzuar aktvendimin e trashëgimisë T.nr.50/90 dt. 06 shtator 1990, që dëshmon se paditësi ishte trashëgimtar i paraardhëses së tij.

Me 16 maj 2023, gjykata i ftoj palët për një seancë dëgjimore.

Me 02 maj 2023, përfaqësuesi i djalit të paditësit, dorëzoi një parashtrësë në gjykatë dhe kërkoj ndërprejen e procedurës, për shkak se paditësi kishte vdekur me 21 gusht 2017. Si dëshmi ka bashkangjitur certifikatën e vdekjes për paditësin dhe certifikatën e lindjes për djalin e paditësit të lëshuara me dt. 02 dhjetor 2022 dhe autorizimin e dt. 27 prill 2023 të dhen avokatit nga djali i paditësit B G N.

Me 04 maj 2023, Gjykata me Urdhër ka anuluar seancë dëgjimore që ishte parashikuar të mbahet me 16 maj 2023 dhe i ka njoftuar palët se për veprimet tjera do të njoftohen në formë të shkruar.

Arsyetimi ligjor:

Ndërpritet procedura gjyqësore në këtë çështje juridike.

Neni 76.3 i Ligjit për DHPGJS (ligji nr. 06/L-086) parasheh se: Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore' (LPK me plotësime dhe ndryshime).

Neni 277 a) i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK me plotësime dhe ndryshime) parasheh se Procesi gjyqësor ndërpritet:
kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale;

Në bazë të nenit 280.1 nga po i njëjti ligj, procedura gjyqësore e ndërprerë mbi bazat e parapara me nenin 277 paragrafi 1 pika a) deri d) te këtij akti ligjor do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë.

Në rastin përkatës, nga certifikata e vdekjes vërehet se paditësi ka vdekur me dt. 21 gusht 2017. Në rrethana të tilla *prima facie* sipas nenit 277 dhe 280 të LPK-së, procedura gjyqësore duhet të ndërpritet derisa pasardhësit e paditësit të vdekur të paraqiten në gjykatë dhe të marrin përsipër çështjen gjyqësore në fjalë.

Shpenzimet gjyqësore

Pasi që procedura tani është ndërprerë, në këtë fazë të procedurës gjykata nuk vendosi mbi shpenzimet gjyqësore.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar kryesues

Sylejman Shumolli, Gjyqtar

Manushe Karaqi, Gjyqtare